

**STATUT E AKT-THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ Furre Buke Medinah ” SH.P.K**

**Altin Allko** i biri i **Bashkim Allko** , lindur më 01/09/1987 në Shpatanj , Skrapar dhe banues në Tirane , mbajtës i numrit të identifikimit **I70901002R** madhor e me zotësi te plotë juridike per të vepruar deklaron në këtë statut e akt themelimi si me poshtë

**NENI 1**

**Data e themelimit dhe forma ligjore**

Mbështetur në legjislacionin Shqiptar në përgjithësi dhe ligjin 9901 dt.14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” sot më dt:**25/06/2024** ortaku i vetëm ka vendosur që kjo shoqëri të marrë formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me dispozitat ligjore si më sipër si dhe të statutit që i bashkëngjitet këtij akt-themelimi

**NENI 2**

**Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është “**Furre Buke Medinah**” Sh.p.k

**NENI 3**

**Selia e shoqërisë**

Shoqëria “**Furre Buke Medinah**” Shpk do ta ketë selinë e saj në **Tiranë Njesia Bashkiake Nr.4 , Rruga e Dibres , Pallati Orion , Hyrja 5 , Kati 1** por me vendimin e ortakut mund të ngrihen edhe degë , filiale apo seli në vënde të tjera brënda dhe jashtë shtetit Shqiptar .

**NENI 4**

**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme referuar ligjit 9901 dt.14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” .

**NENI 5**

**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë do te jetë :

Aktivitet në fushën e perpunimit te brumit : Furre Buke , Piceri , prodhim dhe tregtim i bukes , prodhim e tregtim embelsirash , pastičeri .

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të bëjë ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj , duke bërë ndryshimet përkatëse .

## NENI 6

### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë do të jetë 100 000 lekë kontribut i ortakut , i ndarë në 1 kuotë . Ky kapital do të zotërohet në masën 100 % nga ortakët i vetëm .

## NENI 7

### **Shlyerja e kapitalit themeltar te shoqërisë**

Mbeshtetur në ligjin nr.9901 datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe me ndryshimet e bëra , shlyerja e kapitalit do të kryhet pjesë pjesë nga ortakët i vetëm i shoqërisë në një llogari bankare ku do të kryhen edhe transaksionet e shoqërisë , ose pranë një noteri . Modalitetet dhe afatet e shlyerjes së kapitalit percaktohen me vendim te asamblesë së ortakëve .

## NENI 8

### **Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit**

Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë mund të bëhet nëpërmjet nënshkrimeve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve , e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë .

## NENI 9

### **Transferimi I kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie më përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo mund të kalohen nëpërmjet :

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- Shitblerjes
- Dhurimit
- Trashëgimisë
- Cdo menyre tjetër të parashikuar në ligj

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve , për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme nëpërmjet trashëgimisë .

## NENI 10

### Organet vendimmarrëse

Asambleja e ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë .

Asambleja e ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara me ligj .

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithëshme , në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo një person i tretë .

## NENI 11

### Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron administrator të shoqërisë **Z . Altin Allko** i biri i **Bashkim Allko** , lindur më 01/09/1987 në Shpatanj , Skrapar dhe banues në Tirane , mbajtës i numrit të identifikimit **I70901002R**.

Afati i emërimit është 5 vjet sipas nenit 95 të ligjit 9901 dt.14/04/2008 “për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ndryshimet e bëra .

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit i referohen ligjit 9901 dt.14/04/2008 “për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ndryshimet e bëra .

## NENI 12

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë si dhe ligjin 9901 dt.14/04/2008 “për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

## NENI 13

### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

1. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj .
2. Me vendim të asamblesë së ortakëve .
3. Me hapjen e procedurave të falimentimit .
4. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr 9723 , datë. 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”
5. Veprimtaria e shoqërisë mund të mbyllet edhe kur gjatë dy viteve të njëpasnjëshëm veprimtaria e shoqërisë nuk është rentabël .
6. Me vendim të gjykatës

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë , duke caktuar 1 apo disa likuidator dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën “shoqëri në likuidim e sipër”

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë , duke caktuar 1 apo disa likujdator dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën “shoqëri në likujdim e sipër”

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjëndjen e aftësisë paguese , me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi .

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga ortakët .

#### **NENI 14**


#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti , si dhe për mosmarrëveshje që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve , do të jetë kompetente Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë .

*Ky akt themelimi e statut u nënshkrua sot më 25/06/2024*

**ORTAKU**

**ALTIN ALLKO**

A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping loops and a long horizontal stroke extending to the right.